



Bazuar në nenin 35, paragrafi 1.1, të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 77 / 16 gusht 2010) dhe nenin 14, paragrafi 14.7, të Ligjit Nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale në Kosovë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10 / 8 maj 2012), Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 08 qershor 2022, miratoi këtë:

RREGULLORE PËR PËRFITIMET PENSIONALE TË FONDEVE PLOTËSUESE PENSIONALE TË PUNËDHËNËSIT

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Qëllimi i kësaj Rregulloreje është të përcaktojë udhëzimet për përfitimet që mund të sigurohen nga Fondi Plotësues Pensional i Punëdhënësit dhe që përfshin pensionin me shuma të caktuara dhe kontribute të caktuara.
2. Kjo Rregullore do të zbatohet për Fondet Plotësuese Pensionale të Punëdhënësit.

Neni 2

Përkufizimet

1. Të gjitha termet në këtë Rregullore kanë të njëjtin kuptim me termet e përcaktuara në nenin 1 të Ligjit Nr. 04/L-168 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës dhe nenin 1 të Ligjit Nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës (në vijim: Ligji për Fondet Pensionale) dhe/ose me përkufizimet si më poshtë për qëllimin e kësaj Rregulloreje:
 - 1.1. **Supozimet aktuariale** – nënkupton një numër të përlllogaritjeve financiare dhe demografike që përdoren për të llogaritur kontributet e nevojshme për financimin e përfitimeve pensionale sipas marrëveshjeve të pensioneve me përfitime të caktuara (marrëveshje e pensionit me shuma të caktuara). Këto supozime përfshijnë mes tjerash, normat e interesit, rritjen ekonomike, shkallën e vdekshmërisë, shkallën e paaftësisë, shkallën e rritjes së pagave ose ndryshimet në kulturën e përgjithshme të kompensimit.
 - 1.2. **Shërbim i akumuluar** – nënkupton vitet e shërbimit dhe/ose kontributet e grumbulluara të një pjesëmarrësi lidhur me të drejtat e tij të ligjshme. Vitet e shërbimit do të llogariten nga data efektive e ligjeve ose e rregullave normative pensionale apo nga fillimi i pagimit të kontributeve në emër të punonjësit. Shërbimi do të llogaritet pasi punonjësi të krijojë marrëdhënie pune.

- 1.3. **Pensioni invalidor** – nënkupton të drejtën për të filluar beneficionet e pensionit të përcaktuar sipas ligjit në fuqi për pjesëmarrësin, të cilit i është caktuar invaliditeti i definuar në Ligjin mbi Pensionin Invalidor, që i jep atij të drejtën për pension invalidor.
- 1.4. **Pensioni i shtyrë** – nënkupton përftimin pensional për të cilin pjesëmarrësi ka të drejtat e fituara (ang.: vested rights) me ndërprerjen e punësimit para moshës së pensionit mirëpo ky përfitim shtyhet deri në moshën e pensionimit.
- 1.5. **Përfitimi i hershëm i pensionit** – nënkupton dispozitën në Rregullën e brendshme të pensionit që lejon pjesëmarrësin, i cili pensionohet para moshës së pensionit të marrë pensionin. Përfitimi i hershëm i pensionit nuk mund të fillojë para moshës 60 vjeçare ose 35 vitesh shërbimi.
- 1.6. **Fitimet** – nënkupton totalin e pagës vjetore ose të hyrat nga paga të një individi siç është përcaktuar me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës për tatimin në të ardhurat personale.
- 1.7. **Fitimi i bazës së pensionit** – nënkupton fitimin ose pjesën e fitimit të pjesëmarrësit, vlera e së cilës mund të definohet në Aktet Normative të Fondit Pensional, të përdorur si bazë për llogaritjen e vlerës së kontributeve dhe benefiteve të pensionit.

Neni 3

Përfitimet Pensionale të Fondit Pensionale me Shuma të Caktuara

1. *Bazat për përcaktimin e përfitimit të pensionit.* Aktet Normative të Fondit Pensional duhet të parashohin se përfitimi i pensionit të përcaktohet me metodën e llogaritjes e cila merr parasysh elementet si në vijim:
 - 1.1. Mesatarja e pagës së indeksuar apo pagës së pjesëmarrësit, gjatë të gjitha viteve të akumuluar ose mjetet e kredituara të shërbimit. Paga duhet të indeksohet për të përfshirë efektin e inflacionit ose efektet e lidhura me referencat tjera të caktuara. Vlera e pagës, përfshirë indeksimin, nuk duhet të tejkalojë limitin e fitimeve të bazës së pensionit, të përcaktuara me Rregulloren për Vlerën e Kontributeve të Pensionit.
 - 1.2. Përfitimi i pensionit, nuk duhet të jetë më i lartë se lartësia maksimale e përfitimit të përcaktuar me këtë Rregullore. Në përcaktimin e lartësisë maksimale të përfitimit:
 - 1.2.1. Shkalla e përfitimit të akumuluar nuk duhet të tejkalojë dy vjet të shërbimit të kredituar; dhe
 - 1.2.2. Lartësia maksimale e përfitimit nuk duhet të jetë më e lartë se 80% e mesatares së pagës së indeksuar, vlerë e cila mund të mos e tejkalojë vlerën e fitimit të bazës së pensionit.
2. *Përfitimi maksimal mujor i pensionit.* Baza e pensionit e fituar është e kufizuar në shumë prej 24.000 euro për vit. Prandaj duke zbatuar lartësinë e përfitimit të pensionit prej 80%, përfitimi maksimal i pensionit vjetor është 19.200 euro, ose 1.600 euro në muaj.
3. *Të drejtat e fituara për përfitimin e pensionit.* Aktet Normative të Fondit Pensional mund të specifikojnë numrin e caktuar të viteve të akumuluar të shërbimit për një pjesëmarrës, për t'u shërbyer si kusht për pjesëmarrësin që të sigurojë të drejta të pjesshme ose të plota të përfitimit

të pensionit të tij, ku numri i viteve të akumuluar të shërbimit për të siguruar të drejta të plota nuk mund të tejkalojë 5 vite.

4. *Përfitimi i hershëm i pensionit.* Nëse përfshihet si përfitim i hershëm i pensionit në Aktin Normativ të Fondit Pensional, shuma e pensionit për një pjesëmarrës i cili zgjedh të dalë në pension para moshës së pensionit reduktohet me përqindje ose përqindje të caktuar për çdo numër të viteve të mbetura deri në moshën 65 vjeçare; me kusht që, në asnjë rast, shuma e përfitimit të pensionit nuk tejkalon vlerën aktuale të përfitimit të pensionit të parashikuar në aktet nënligjore të pensionit dhe përcaktohet nga Raporti i fundit i Vlerësimit Aktuarial menjëherë para datës së daljes në pension të parakohshëm.
5. *Përfitimi i pensionit invalidor.* Nëse përfshihet si përfitim në Aktet Normative të Fondit Pensional, vlera e kualifikimit të pensionit invalidor nuk duhet të tejkalojë 70% të pagës së indeksuar mesatare të pjesëmarrësit gjatë viteve të akumuluar të shërbimit dhe gjatë kualifikimit të invaliditetit të tij. Pensioni Invalidor duhet të paguhet deri në datën e përfundimit të pensionit invalidor ose nëse pjesëmarrësi ka arritur moshën e pensionit.
6. *Përfitimi i mbijetesës.* Nëse pjesëmarrësi që është i martuar vdes para moshës së pensionimit, përfitimi i pensionit që është i barabartë me së paku 50% të pensionit të tij, bëhet përfitim i pensionit të shtyrë për bashkëshortin/-en e tij/saj.
7. *Pagesa e përfitimeve të pensionit.* Pensionet duhet të paguhen në baza mujore të llogaritura me anë të formulës së pagesës së pensionit të shumave të caktuara në Aktet Normative të Fondit Pensional. Nëse formula e pagesës së përfitimeve të pensionit është e shprehur në shumë totale, konvertimi në pagesa mujore të barabarta duhet të jetë në pajtim me tabelën e përfitimeve që është pjesë e Akteve Normative të Fondit Pensional, bazuar në supozimet aktuariale.
8. *Përfitimet e pensionit të shtyrë.* Pjesëmarrësit të cilit i ndërpritet marrëdhënia e punës, mundet që të drejtat e fituara në Fondin Pensional t'i lë si pension i shtyrë. Ky pension i shtyrë është i barabartë me të drejtat e fituara të pjesëmarrësit në datën e përfundimit të marrëdhënies së punës. Pagesat e pensioneve mund të fillojnë vetëm në moshën e pensionimit ose në opsionin kur pjesëmarrësi ka fituar të drejtën për pension të hershëm. Nëse një individ ka pension të shtyrë dhe vdes para marrjes së pensionit, përfitimet pensionale të shtyra do të paguhen sipas Akteve Normative të Fondit Pensional, duke i respektuar të drejtat e pjesëmarrësve në rast të vdekjes.
 - 8.1. Nëse pjesëmarrësi që e ndërpret marrëdhënien e punës nuk ka të drejtë në pension të shtyrë, akumulimi i kontributit të punëdhënësit në llogari të pjesëmarrësit duhet të aplikohet si kontribut i punëdhënësit për vitin financiar në llogari dhe për përfitime të pjesëmarrësve tjerë.
9. *Llogaritja e viteve të shërbimit të akumuluar ose të mjeteve të kredituara.* Udhëzimet që përcaktojnë vitet e shërbimit të akumuluar ose të kredituar, janë si në vijim:
 - 9.1. Moshë minimale e pranueshmërisë së pensionit është 18 vjeç, ndërsa maksimumi i viteve të shërbimit të akumuluar ose mjeteve të kredituar është për 46 vite.
 - 9.2. Numri maksimal i viteve të shërbimit të akumuluar ose kredituar nuk duhet të tejkalojë numrin e viteve që pjesëmarrësi është ose ishte i punësuar nga punëdhënësi aktual, duke i shtuar numrin e viteve të shërbimit të punëdhënësit të mëhershëm, duke marrë në konsideratë kërkesat si më poshtë:

- 9.2.1. Periudha e viteve të shërbimit të kredituara nga punëdhënësi i mëhershëm mund të lejohet vetëm në rast se janë transferuar mjete të mjaftueshme, si dhe përmbushin obligimet e Fondit të ri Pensional.
- 9.2.2. Punonjësi i ri, punëdhënësi i ri dhe Fondi Pensional pajtohen përmes një kontrate duke caktuar shumën e mjeteve që kërkohet të transferohet te fondi i punëdhënësit të ri, me qëllim që të mbulojë vitet e shërbimit të punonjësit për periudhën e mëhershme të punësimit të asaj/atij dhe që përfshirja e viteve të shërbimit është subjekt i kushteve që fondet e lartpërmendura të pranohen nga Fondi Pensional brenda periudhës 30 ditore nga pjesëmarrja e re e punonjësit dhe që të drejtat e fituara të të gjithë pjesëmarrësve aktualë nuk ndikohen negativisht.
- 9.2.3. Një kopje e deklaratës së shkruar dhe e dokumentit që evidenton transferin e Fondit Korrespondues në Fondin Pensional të përmendur në paragrafin 9.2.2 të këtij neni, duhet të dorëzohet në BQK brenda 45 ditësh nga data e pjesëmarrjes së punonjësit të ri.
- 9.3. Në rast të përfitimit pensional të invaliditetit apo të vdekjes, periudha e viteve të kredituara të shërbimit duhet të përfshijë numrin e viteve ndërmjet datës së kualifikimit të invaliditetit ose vdekjes dhe datës kur pjesëmarrësit arrijnë ose do të kishin arritur moshën 65 vjeçare.
- 9.4. Pjesëmarrësi i cili është ripunësuar brenda periudhës prej 30 ditësh (nga i njëjti punëdhënës), konsiderohet se ka mbajtur shërbim të vazhdueshëm dhe të pandërprerë për qëllimin e Fondit Pensional të punëdhënësit sponsorues, duke marrë në konsideratë kushtet si në vijim:
- 9.4.1. Të drejtat e fituara të punonjësit të ripunësuar janë ende në Fondin Pensional si pension i shtyrë; ose
- 9.4.2. Punonjësi i ripunësuar ka bërë transferimin e të drejtës së tij të fituar në një skemë tjetër pensionale, vlera e të drejtave të fituara të transferuara është kthyer dhe pranuar nga Fondi Pensional brenda periudhës prej 30 ditësh prej datës kur pjesëmarrësi është ripunësuar.
- 9.5. Ndërprerjet përgjatë një viti të shërbimit duhet të kalkuloohen në baza proporcionale në përcaktimin e përfitimeve dhe kontributeve pensionale.

Neni 4

Përfitimet Pensionale të Fondit Pensionale me Kontribute të Caktuara

1. *Baza për përcaktimin e përfitimit të pensionit.* Aktet Normative të Fondit Pensional duhet të parashohin se përfitimet pensionale duhet të jetë shuma e fondeve e llogaritur dhe e përcaktuar në pajtueshmëri me Rregulloren mbi Llogaritë Individuale të Pjesëmarrësve, të alokuar në llogarinë individuale të pjesëmarrësit sipas vlerësimit të muajit të fundit para fillimit të pensionit. Vlera e mjeteve pensionale me kontribut të caktuar në llogarinë individuale të pjesëmarrësit përbëhet prej shumës së elementeve si në vijim:
 - 1.1. Gjithsej kontributet e bëra nga pjesëmarrësi gjatë gjithë periudhës së kontribuimit të tij;
 - 1.2. Gjithsej kontributet e bëra nga punëdhënësi në emër të pjesëmarrësit gjatë gjithë periudhës së kontribuimit;

- 1.3. Kthimet nga investimet të alokuara në shumat e përshkruara në paragrafët 1.1 dhe 1.2 të këtij neni, duke i zbritur kostot e arsyeshme të administrimit të pensionit.
2. *Shuma mujore e përfitimit të pensionit.* Fondi Pensional duhet të blejë një Kontratë Anuiteti prej Kompanisë së Sigurimit të Jetës, në pajtim me kërkesat ligjore dhe rregullative të BQK-së. Anuiteti do të paguajë pensionet mujore. Shuma e pensioneve mujore përcaktohet nga:
- 2.1. Shuma e mjeteve në llogarinë individuale të pjesëmarrësit, në datën e pensionit,
- 2.2. Moshë e pjesëmarrësit; dhe
- 2.3. Opsioni i përzgjedhur i pagesës apo shlyerjes.
3. *Të drejtat e fituara.* Të drejtat e fituara të pjesëmarrësit në pensionin me kontribut të caktuar janë të barabarta me shumën e mjeteve të alokuara në llogarinë individuale të atij sipas datës së fundit të vlerësimit.
4. *Përfitimi i hershëm i pensionit.* Nëse përfshihet si përfitim në Aktet Normative të Fondit Pensional, pjesëmarrësi që zgjedh të pensionohet para moshës së pensionit, mund të fillojë pensionin (Përfitimi i hershëm i pensionit). Shuma e mjeteve në llogarinë individuale të pjesëmarrësit që përbën të drejtën e fituar të atij, sipas datës së fundit të vlerësimit të muajit para fillimit të pensionit të hershëm të tij duhet të përdoret për të blerë anuitetin sipas paragrafit 2 të këtij neni.
5. *Përfitimi i pensionit invalidor.* Nëse përfshihet si përfitim në Aktet Normative të Fondit Pensional, shuma e kualifikuar e pensionit invalidor nuk duhet të tejkalojë 70% të mesatares së rrogës së indeksuar ose pagës së pjesëmarrësit gjatë viteve të kredituara të shërbimit të atij. Pensioni invalidor duhet të jetë i pagueshëm deri në datën kur invaliditeti pushon ose deri në moshën e pensionimit atëherë kur pjesëmarrësi ka të drejtë në pensionin e rregullt.
6. *Përfitimi i mbijetesës.* Nëse pjesëmarrësi që është i martuar vdes para moshës së pensionit, përfitimi i pensionit i barabartë me të drejtat e fituara (bilanci i llogarisë individuale) sipas datës së fundit të vlerësimit para muajit të vdekjes caktohet si përfitim pensional i shtyrë për bashkëshortin/-en e tij/saj.
7. *Përfitimi i pensionit të shtyrë.* Pjesëmarrësit të cilit i ndërpritet marrëdhënia e punës, mundet që të drejtat e fituara në Fondin Pensional t'i lë si pension i shtyrë. Ky pension i shtyrë është i barabartë me të drejtat e fituara të pjesëmarrësit në datën e përfundimit të marrëdhënies së punës. Pagesat e pensioneve mund të fillojnë vetëm në moshën e pensionimit ose në opsionin kur pjesëmarrësi ka fituar të drejtën për pension të hershëm. Nëse një individ i cili ka pension të shtyrë vdes para marrjes së pensionit, përfitimet pensionale të shtyra do të paguhen sipas Akteve Normative të Fondit Pensional, duke i respektuar të drejtat e pjesëmarrësve në rast të vdekjes.

Neni 5

Zbatimi dhe Masat Përmirësuese

Shkeljet e dispozitave të kësaj Rregulloreje do të jenë subjekt i masave të parashikuara sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 6
Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, do të shfuqizohet “Rregulla 17 mbi Vlerën e Benefiteve të Pensionit e aplikueshme për Fondin e Pensionit Suplementar të Punëdhënësit”, e miratuar më 23 tetor 2002.

Neni 7
Hyrja në Fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data e miratimit të saj.

Flamur Mrasori

Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës